

Pranuar me dt. 12.07.2024			
Njësia orga	Num	Nr.Ekzem	Vlera
	1528		

UNIVERSITETI "ISA BOLETINI" MITROVICË

Rr. Ukshin Kovaçica. 40000 Mitrovicë
Republika e Kosovës Tel: +383 28 515 516
E-mail: info@umib.net

Në mbështetje të nenit 3 të Rregullores për Financimin e Veprimtarisë Kërkimore-Shkencore në UIBM, nr. prot, 769, të datës 31.03.2024, publikohet:

Thirrja

**Për aplikim të stafit akademik të UIBM-së për mbështetje
financiare të publikimeve shkencore, për vitet 2023 dhe 2024.**

Universiteti "Isa Boletini", në Mitrovicë, ka krijuar kushte për veprimtari kërkimore-shkencore, duke e ndihmuar stafin akademik edhe financiarisht që të arrijë rezultate konkurruese në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Ftohen të gjithë anëtarët e stafit akademik që kanë publikuar punime shkencore në emër të UIBM-së, me simbolet dhe adresat e komunikimit zyrtar të UIBM-së, që të aplikojnë për mbështetje financiare për punimet e publikuara gjatë vitit 2023 dhe 2024.

Me këtë thirrje, në bazë të Rregullores për Financimin e Veprimtarisë Kërkimore-Shkencore në UIBM, financohen publikimet shkencore me cilësi të lartë, pjesëmarrja në ngjarje shkencore dhe projekte kërkimore të nivelit të pranueshëm akademik.

Për të fituar të drejtën për mbështetje financiare, personeli akademik duhet të dorëzojë këto dokumente:

Për punimet e publikuara shkencore

Dokumentacioni që kërkohet:

1. Formulari i aplikimit Formulari 1
2. Artikulli i plotë, <https://www.doi.org/> emrin e revistës, Indeksimin në platformën përkatëse, faktori i impaktit, data e pranimit të punimit apo publikimit on-line.
3. Detaje mbi prezantimin e punimit në formë të seminarit në katedrën/njësine akademike, nga e cila vjen autori/ bashkautori i punimit. Ftesën (e-mailin) nga shefi i departamentit drejtuar stafit të njësisë me datën, orën dhe sallën për mbrojtjen e punimit në formë seminari.
4. Një shkresë nga dekanët e njësive akademike apo udhëheqësit e departamenteve që shpjegon përfitimin shkencor nga publikimi i punimit përkatës shkencor për Universitetin.

Dokument shtesë

5. Deklaratën nën betim e nënshkruar se punimi nuk ka marr; përkrahje financiare nga buxheti i MASHT.

6. Të gjitha dokumentet dorëzohen në formë fizike në ZBN, dhe në formë elektronike në adresën elektronike abdullah.sadiku@umib.net . Formulari në formë elektronike dorëzohet në formatin Word me linkun aktiv për klikim.

Për konferenca dhe simpoziume shkencore

Dokumentacioni që kërkohet:

1. Formulari 2 për aplikim
2. Prezantimi apo abstrakti
3. Detaje në lidhje me ngjarjen shkencore që do të ndiqet, si: data, qëllimi, arritjet dhe programi
4. Dokumentet që tregojnë pranimin e punimit/posterit, abstraktit për prezantimin në një kongres, konferencë, simpozium dhe praninë e tij në programin e ngjarjes, si dhe një letër personale të ftesës ose pranimin për prezantimin
5. Dokumentacioni i shkruar i ftesës së aktivitetit apo ngjarjes për kandidatin si folës ose instruktor
6. Një shkresë nga dekanët e njësive akademike apo udhëheqësit e departamenteve që shpjegon përfitimin shkencor nga pjesëmarrja në ngjarjet shkencore për Universitetin
7. Biletat, faturat e biletave, faturat e akomodimit, faturën e regjistrimit të ngjarjes shkencore.

Dokument shtesë

8. Deklaratën e nënshkruar se punimi nuk ka marr përkrahje financiare nga buxheti i MASHT.
9. Kërkesa duhet të bëhet të paktën një muaj para datës së ngjarjes, për të cilin bëhet kërkesa.

Thirrja publikohet në web - faqen e UIBM dhe është e hapur nga 02.09.2024 deri më datën 30.09.2024

Prof. Ass. Dr. Bahtir Hyseni,
Prorektor për Hulumtime dhe
Kërkime shkencore

